

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5606  
E premte, 19 tetor 2018  
çmimi 0.40 €

## Hoxhaj dhe Ruçi kërkojnë unifikim për dialogun me Serbinë

FAQE 2



KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS KA MIRATUAR PROJEKTLIGJET PËR  
TRANSFORMIMIN E FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS (FSK) | FAQE 4-5

# BËHET USHTRIA

- FSK-ja  
bëhet me  
mandat  
ushtarak  
dhe  
mbrojtës



Kuvendi i Kosovës ka miratuar të  
enjten në parim tri projektligjet që i  
hapin rrugë ndryshimit të mandatit të  
Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).  
Këto projektligje që mundësojnë  
ritjen e përgjegjësive për këtë forcë u

përkrahën nga të gjitha partitë politike  
në Kuvend, përveç Listës Serbe.  
Përmes këtyre tri projektligjeve Forca e  
Sigurisë së Kosovës do të transformohet  
në një forcë me kapacitete shtesë,  
përfshirë edhe përgjegjësi të mbrojtjes,

pa prekur në emrin e saj. Misioni i ri i  
FSK-së do të jetë: Mbron integritetin  
territorial të Republikës së Kosovës;  
Forcë ushtarake shumetnike e  
armatosur; FSK-ja vepron brenda dhe  
jashtë vendit

## Liderët: Anëtarësimi i Kosovës në Interpol ruan paqen dhe rrit sigurinë në rajon

FAQE 3



Anëtarësimi i shtetit të Kosovës në Interpol do të  
ndikojë në ruajtjen e paqes dhe në rritjen e  
sigurisë në rajon dhe më gjerë. Kështu kanë  
deklaruar të enjten liderët shtetërorë të Kosovës,  
presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri  
Ramush Haradinaj, në konferencën për shënimin  
e Ditës së Bashkimit Evropian Kundër Trafikimit të  
Qenieve Njerëzore. Ata kanë vlerësuar se Kosova,  
duke qenë pjesë e Interpolit, do të jetë më e aftë  
në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore

## Kosova e nderon Vasfije Krasniqin- Goodman



FAQE 8

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

**FJALORI  
ENCIKLOPEDIK I  
KOSOVËS, FJALOR  
KUNDËRKOMBËTAR**



F. 11

Rexhep QOSJA

**KUVENDI RATIFIKON  
MARRËVESHJET PËR  
SIGURIME SOCIALE ME  
ZVICRËN DHE BELGJIKËN** F. 6

**KOMUNA E PRISHTINËS I KA  
BORXH UJËSJELLËSIT 307  
MIJË EURO** F. 11

### EKONOMI

**RATIFIKOHET MARRËVESHJA  
E 2.4 MILIONË EUROVE NË  
MES TË MINISTRISË SË  
INOACIONIT DHE GIZ-it** F. 8

**SEKTORI I MINIERAVE, NË  
FOKUS TË INVESTITORËVE  
KANADEZË** F. 8

### KULTURË

**MINISTRI GASHI: STRATEGJIA  
E KULTURËS TË PËRFSHIJË  
KONSULTIME TË TË GJITHË  
AKTORËVE** F. 13



### SPORT

**FIFA: KOSOVËN E PRET NJË  
E ARDHME E NDRITUR** F. 16

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## NATO-ja ka nisur bisedimet me Maqedoninë

**BRUKSEL, 18 TETOR** - Në selinë e NATO-s në Bruksel të enjten filluan bisedimet në mes të delegacionit të Maqedonisë dhe zyrtarëve të Aleancës për anëtarësimin e këtij vendi ballkanik. Bisedimet përfshijnë aspektet politike, ushtarake e juridike, ndërsa pritet të caktohet një afat kohor për përfundimin e procesit që, sipas pritjeve në Shkup, do të ndodhë në muajin dhjetor.

Delegacionin e Maqedonisë e drejton ministrja e Mbrojtjes Radmilla Sheqerinska. Delegacioni u prit nga nënsekretari i përgjithshëm i NATO-s, Alejandro Alvaro Gonzales. Autoritetet e Shkupit thonë se Maqedonia ka realizuar reforma të dukshme kundrejt arrijtes së standardeve të vendeve anëtare të Aleancës Veriatlantike. Megjithatë, vendi i vogël ballkanik

duhet edhe më tej ta modernizojë ushtrinë dhe ta shtojë buxhetin për të. Për anëtarësimin në Aleancë duhet që ligjvënësit në Shkup t'i miratojnë ndryshimet kushtetuese që burojnë nga Marrëveshja e Prespës lidhur me emrin e Republikës së Maqedonisë. Sipas pritjeve, Maqedonia mund të bëhet anëtare fuqplotë e Aleancës së NATO-s në pranverën e vitit 2020.



## Veseli: Gjermania do ta mbështesë Kosovën në të gjitha fushat

Zyrtarë të lartë gjermanë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Kancelarisë gjermane i kanë konfirmuar kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veselit, se Gjermania do ta mbështesë Republikën e Kosovës në të gjitha fushat

**PRISHTINË, 18 TETOR** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka takuar në Berlin zyrtarë të lartë gjermanë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në Kancelarinë gjermane, ku ka marrë rikonfirmimin se Gjermania do ta mbështesë Republikën e Kosovës në të gjitha fushat. Në takim me zyrtarin e lartë gjerman Jan Hecker, kryeparlamentari Veseli ka diskutuar për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën dhe për fazën finale të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Veseli ka marrë mbështetjen e Qeverisë së Gjermanisë për procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës.

Gjatë diskutimit për çështjen e dialogut, kryeparlamentari Veseli e ka njoftuar zyrtarin gjerman për përpjekjen e tij prej disa muajsh për të arritur konsensus brenda Kuvendit të Kosovës për nxjerrjen e një rezolute, e cila rikonfirmon qëndrimet e shtetit të Kosovës për integritetin territorial dhe pacenueshmërinë e sovranitetit. Pas takimeve në Kancelarinë gjermane, kryetari i Kuvendit të



Kosovës ka takuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të ngarkuarin për Ballkanin Perëndimor, Christian Hellbach. Kryeparlamentari Veseli e ka njoftuar diplomatën gjerman për

zhvillimet politike në Kosovë dhe rajon. Veseli ka thënë se Kosova ka ndërmarrë reformat e nevojshme për procesin e integritetit evropian, reformat në ekonomi dhe në fushën e sistemit të drejtësisë.

### LAJME SHKURT

#### Hoxhaj e Ruçi kërkojnë unifikim për dialogun me Serbinë

**PRISHTINË, 18 TETOR** - Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, ka pritur të enjten në takim zëvendëskryeministrin e Kosovës, Enver Hoxhaj, me të cilin ka biseduar për përshtetimin e procesit të integritetit evropian të Kosovës dhe për procesin e liberalizimit të vizave për shtetasit kosovarë. Me këtë rast është thënë se Kosova ndodhet para fazës përfundimtare të vendimmarrjes për liberalizimin e vizave dhe në këtë fazë është i domosdoshëm shtimi i kontakteve të bashkëpunimit me qeveritë e vendeve anëtare për kurorëzimin me sukses të këtij procesi.

Kryeparlamentari Ruçi ka shprehur mbështetjen e plotë për angazhimin aktiv të Shqipërisë në këtë proces të rëndësishëm për Kosovën dhe shtetasit e saj. Në takim, Ruçi e Hoxhaj kanë biseduar edhe mbi çështjen e korigjimit të kufijve, ku kanë theksuar se procesi i negociatave me Serbinë duhet të nisët nga dy premisa themelore: unifikimi i qëndrimeve politike dhe institucionale të Kosovës dhe garantimi i mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë.



#### Ambasadori i ri i Zvicrës i paraqet letrat kredenciale presidentit Meta

**TIRANË, 18 TETOR** - Presidenti i Republikës, Ilir Meta, pranoi të enjten Letrat Kredenciale nga ambasadori i ri i Konfederatës Zvicerane, Andre Maître. Presidenti Meta vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera midis dy vendeve dhe shprehu mirënjohjen për mbështetjen dhe asistencën teknike zvicerane, për Shqipërinë, që nga viti 1992. Duke u ndalur në mundësitë e forcimit të bashkëpunimit ekonomik, Meta nënvizoi se numri i investimeve dhe pranisë së kapitaleve dhe kompanive zvicerane në Shqipëri është rritur ndjeshëm në vitet e fundit. "Krijimi para një viti i Dhomës së Tregtisë Zvicer-Shqipëri është shumë pozitiv dhe mundësitë për bashkëpunim në këtë drejtim janë të shumta", u shpreh presidenti Meta. Presidenti Meta vlerësoi përvojën e pasur në fushën e bashkëpunimit për zhvillim dhe shprehu besimin se falë kësaj përvaje projektet zvicerane të zhvillimit në Shqipëri do të marrin një nxitje dhe një dinamikë edhe më të madhe.



## Anija e Forcës Detare shqiptare shpëton 73 emigrantë në detin Egje

**TIRANË, 18 TETOR** - Anija "Lissus" e Forcës Detare shqiptare mori pjesë në dy operacione të ndryshme për shpëtimin dhe parandalimin e emigrantëve në detin Egje. Në harkun e pak orëve, anija shqiptare diktoi një gomone me 33 persona që po merrte ujë dhe shoqëroi një tjetër me

40 persona të pikasur nga roja bregdetare turke. Sipas përgjegjësive, anija shqiptare ka mbajtur në mbikëqyrje gomonen e parë, ku personat në bord po hiqnin ujë me mjete rrethore. Gjithashtu, ekuipazhi shqiptar, i përbërë nga zhytës dhe infermierë dhe i pajisur me gomonen e anijes,

ka qëndruar në gatishmëri për evakuimin e personave në rast emergjent. Brenda pak minutash të 33 personat në gomone, nga të cilët 19 burra, 6 gra dhe 8 fëmijë sirianë, iranianë, palestinezë dhe kuvajtanë, u imbarkuan në bordin e anijes së Frontex.

Në një operacion të dytë mesnatën e së mërkurës, anija "Lissus" ka shoqëruar një gomone me 40 persona, e cila u pikas nga roja bregdetare turke. Anija shqiptare mbajti nën kontroll gomonen, deri në imbarkimin e personave në bord, të cilët u dërguan për veprime në portin e Çeshmes.





Është mbajtur konferenca për shënimin e Ditës së Bashkimit Evropian Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

# Liderët: Anëtarësimi i Kosovës në Interpol ruan paqen dhe rrit sigurinë në rajon



Anëtarësimi i shtetit të Kosovës në Interpol do të ndikojë në ruajtjen e paqes dhe në rritjen e sigurisë në rajon dhe më gjerë. Kështu kanë deklaruar të enjten liderët shtetërorë të Kosovës, presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj, në konferencën për shënimin e Ditës së Bashkimit Evropian Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Ata kanë vlerësuar se Kosova, duke qenë pjesë e Interpolit, do të jetë më e aftë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore

**EPOKA  
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHINË, 18 TETOR - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) të enjten ka mbajtur konferencën për shënimin e Ditës së Bashkimit Evropian Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në të cilën kanë marrë pjesë presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj, si dhe shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Natalya Apostolova. Me këtë rast ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Ekrem Mustafa, ka thënë se institucionet e Republikës së Kosovës në vazhdimësi kanë treguar një gatishmëri për gjetjen e metodave adekuate për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore. "Prioriteti i të gjitha instancave relevante mbetet parandalimi i kësaj dukurie, i përcjellë edhe me aktivitete të ndryshme që do të jenë pjesë edhe

e kësaj fushate anti-trafikim të qenieve njerëzore, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së opinionit publik dhe ndërgjegjësimit institucional", ka deklaruar Mustafa. Ndërsa presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se Kosova ka krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore dhe politike për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore të harmonizuara me ligjet e Bashkimit Evropian. "Trafikimi i qenieve njerëzore i lëkund themelet e BE-së dhe vazhdon të jetë ndër problemet më fundamentale me të cilat përballet BE-ja edhe sot. Prandaj janë të mirëseardhura mundësitë si kjo sot, që së bashku të bisedojmë për migracionin ilegal, për rreziqet që paraqet për shoqëritë dhe për masat që mund të marrim për ta luftuar atë. Falënderoj BE-në, shtetet anëtare dhe ShBA-në për mbështetjen që i kanë dhënë

Kosovës për ngritjen e kapaciteteve për t'i luftuar të gjitha llojet e krimin ndërkombëtar. Policët kufitarë të Kosovës bëjnë trajnime nëpër vendet e BE-së dhe mësohen t'i zbatojnë politikat e FRONTEX-it edhe në Kosovë. Duke mbrojtur kufijtë e Kosovës e dimë se kontribuojmë edhe për mbrojtjen e kufijve të BE-së", ka deklaruar Thaçi.

Duke folur për bashkëpunimin me shtetet e rajonit, presidenti Thaçi ka deklaruar se për të luftuar me sukses trafikimin e njerëzve është qenësore që bashkëpunimi i mekanizmeve të sigurisë të jetë i papenguar. Në këtë kontekst, ai ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në Interpol do të ndikojë në ruajtjen e paqes dhe në rritjen e sigurisë në Kosovë, rajon dhe mbarë botën. "Jemi anëtarë në Iniciativën Rajonale për Refugjatë, Azil dhe Migracion (MARRI) dhe kontribuojmë në mënyrë aktive në punën e kësaj organizate të suksesshme rajonale. Por, është qenësore që Kosova të jetë e pranishme në të gjithë mekanizmat rajonale dhe ndërkombëtarë të sigurisë. Edhe pse nuk kemi qenë pjesë e Interpolit, Kosova ka qenë jashtëzakonisht e suksesshme në luftën kundër krimin të organizuar, kundër trafikantëve. Kosova duhet të bëjë një hap përpara për ta fituar betejën e vështirë me trafikantët e qenieve njerëzore. Anëtarësimi i Kosovës në Interpol do të ndikojë në ruajtjen e paqes dhe në rritjen e sigurisë në Kosovë, rajon dhe mbarë botën", është shprehur Thaçi.

**Haradinaj: Pas anëtarësimin në Interpol, Kosova më e aftë të luftojë trafikimin e qenieve njerëzore**

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka shprehur përkushtimin e institucioneve që jo vetëm të jenë pjesë e një lufte që bëjnë vendet e BE-së kundër luftimit të trafikimit të qenieve njerëzore, por edhe t'i kenë sukseset e veta. "Kosova është e sfiduar me luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore për shkak se ende nuk është anëtare e Interpolit dhe Evropolit", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se me anëtarësimin në Interpol, Kosova do të jetë më e aftë dhe më në gjendje të zhvillojë partneritet me të gjitha institucionet relevante në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, duke siguruar se në Kosovë të gjitha vendet e Bashkimit Evropian kanë një partner serioz në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Kryeministri Haradinaj ka treguar se Kosova ka hartuar Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimin, është krijuar komisioni për kompensim ndaj viktimës së krimin, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe se Kosova është duke zbatuar Strategjinë dhe Planin e Veprimtimit 2016-2019, e cila është vazhdimësi e dy strategjive të mëhershme në luftën kundër

trafikimit të qenieve njerëzore. Kryeministri ka theksuar se në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar Kosova ka nënshkruar protokollin bashkëpunues në mes të Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Haradinaj ka thënë se Policia e Kosovës në këtë periudhë kohore, me qëllim të identifikimit dhe hetimit të rasteve, ka zhvilluar 21 plane operative, 20 operacione për zbatim të rasteve, 10 operacione të përbashkëta me inspektorët komunalë të punës në Administratën Tatimore të Kosovës, si dhe 18 operacione me njësi të tjera policore. Sipas Haradinajt, në gjysmën e parë të këtij viti Prokuroria e Shtetit ka trashëguar 38 raste me 66 persona dhe ka pranuar 11 raste të reja me 15 persona. Prokuroria gjatë kësaj periudhe ka punuar gjithsej 49 raste ligjore me 31 persona, nga të cilat i ka zgjidhur 14 raste me 24 persona, ndërsa kanë përfunduar 35 raste të tjera me 52 persona. Kurse shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka thënë se mbajtja e kësaj konference është shumë e rëndësishme dhe shërben për ngritjen e ndërgjegjësimit dhe shkëmbimit të informacioneve, njohurive dhe praktikave ndërmjet aktorëve të ndryshëm. Sipas saj, për BE-në lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore është top prioritet në të gjithë botën dhe se angazhimi në luftimin ndaj këtij fenomeni, po aq sa është individual, është edhe shoqëror.



Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar projektligjet për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK)

# BËHET USHTR



## - FSK-ja bëhet me mandat ushtarak dhe mbrojtës

Kuvendi i Kosovës ka miratuar të enjten në parim tri projektligjet që i hapin rrugë ndryshimit të mandatit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Këto projektligje që mundësojnë rritjen e përgjegjësisë për këtë forcë u përkrahën nga të gjitha partitë politike në Kuvend, përveç Listës Serbe. Përmes këtyre tri projektligjeve, Forca e Sigurisë së Kosovës do të transformohet në një forcë me kapacitete shtesë, përfshirë edhe përgjegjësi të mbrojtjes, pa prekur në emrin e saj. Misioni i ri i FSK-së do të jetë: Mbron integritetin territorial të Republikës së Kosovës; Forcë ushtarake shumetnike e armatosur; FSK-ja vepron brenda dhe jashtë vendit

**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 18 TETOR** - Kuvendi i Kosovës i ka miratuar të enjten në parim tri projektligjet e propozuara nga Qeveria për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Përmes këtyre tri projektligjeve po synohet që Forca e Sigurisë së Kosovës të transformohet në një forcë me kapacitete shtesë, përfshirë edhe përgjegjësi të mbrojtjes, por pa prekur në emrin e saj.

Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes është miratuar me 101 vota, ai për Forcën e Sigurisë së Kosovës me 98, kurse Projektligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës me 96 vota. Këto projektligje janë mbështetur nga të gjitha grupet parlamentare, përveç deputetëve të Listës Serbe.

Ministri i FSK-së, Rustem Berisha, në prezantimin para deputetëve të Projektligjit për Ministrinë e Mbrojtjes, ka thënë se hartimi dhe procedimi është

mbështetur në normat kushtetuese në mënyrë që të mundësohet riorganizimi dhe kalimi nga Ministria e FSK-së në Ministrinë e Mbrojtjes. "Ministria e Mbrojtjes do t'i hartojë dhe zbatojë politikat e përgjithshme shtetërore të mbrojtjes në nivel strategjik si dhe do t'i ushtrojë funksionet dhe kompetencat e saj në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi", ka thënë ministri Berisha.

Kryeministri i Kosovës, Ramush

Haradinaj, ka thënë se e mirëpret shqyrtimin e ligjeve për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ndërkohë që u ka thënë deputetëve serbë se ata duhet të ndihen të sigurt se transformimi i FSK-së nuk do të ndikojë për të keq te komunitetet pakicë. "Kanë arsye të ndihen të sigurt të gjitha komunitetet, pra kjo është një punë që bëhet për të gjithë qytetarët e vendit. Sa iu takon funksioneve, të tri ligjet e kanë një detyrë dhe ajo është mbrojtja e integritetit territorial të Republikës së Kosovës, mbrojtja e qytetarëve dhe komuniteteve të Republikës së Kosovës, mbrojtja ushtarake e civile dhe pjesëmarrja në operacione ndërkombëtare", ka deklaruar Haradinaj para deputetëve të Kuvendit.

Ndërkaq gjatë debatit parlamentar shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës,

Avdullah Hoti, ka thënë se angazhimi i Kosovës për mandat të ri për FSK-në nuk është kërkesë që tejkalon atë që tashmë vendet e rajonit e kanë, përkatësisht ushtrinë. Ai i quajti të pabaza deklaratat në Beograd kundër ushtrisë së Kosovës. "Vetëm ata që janë kundër NATO-s janë kundër mandatit të ri të FSK-së dhe vetëm ata që janë kundër interesave euroatlantike në Kosovë e rajon janë kundër që shteti i Kosovës ta ketë ushtrinë. Vetëm ata që promovojnë interesa të tjera në Ballkan, si ato të federatës ruse apo të ngjashme, janë kundër ushtrisë së Kosovës", ka thënë Hoti.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka deklaruar se subjekti që ai përfaqëson i përkrah parimisht projektligjet për FSK-në. "Ne deklarojmë mbështetjen tonë në parim për



## Presidenti uron për ushtrinë: Gjithmonë në nderim të atdheut

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka uruar për votimin e pakove të ligjeve në Kuvendin e Kosovës e cila parasheh transformimin e FSK-së në ushtri. Në profilin e vet në "Facebook", Thaçi ka shpërndarë një video në të cilën janë prezantuar disa stërvitje të pjesëtarëve të FSK-së dhe pjesë e fjalimit të tij, kur si ish-kryeministër kishte bërë publike iniciativën për transformimin e kësaj force. "Gjithmonë duke nderuar atdheun dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve. Bijat dhe bijtë më të mirë të vendit, ushtarët e Republikës së Kosovës", ka shkruar Thaçi.

## Veseli: Kosovë, e gëzofsh ushtrinë

Kryeparlamentari Kadri Veseli, i cili është duke qëndruar për vizitë zyrtare në Gjermani, ka përshëndetur votimin e tri projektligjeve që kanë të bëjnë me transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri. Veseli në llogarinë e vet në "Facebook" ka publikuar një fotografi me mbishkrimin "Kosovë, e gëzofsh ushtrinë".

## Pacolli: Miratimi i projektligjeve për FSK-në, hap drejt forcimit të shtetit

Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka përgëzuar Kosovën dhe popullin e saj për miratimin e tri projektligjeve për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ai ka vlerësuar se shteti ynë sot ka shënuar një hap të rëndësishëm drejt forcimit të vet. Sipas Pacollit, uniteti politik që u reflektua në Kuvend është lajm i jashtëzakonshëm për të ardhmen tonë. "Ushtria e Kosovës dhe shteti ynë është jetësim i amanetit të shumë brezave. Urime Kosovë! Shteti ynë shënoi një hap të rëndësishëm drejt forcimit të vet. Uniteti politik që u reflektua sot në Kuvend është lajm i jashtëzakonshëm për të ardhmen tonë. Ne jemi bashkë kur është në pyetje Kosova", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

## Limaj: Ditë historike. Urime ushtria, Kosovë!

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, njëherësh zëvendëskryeministër, Fatmir Limaj, e ka vlerësuar ditë historikë ditën e sotme ku është votuar pakoja ligjore e FSK-së, e cila mundëson transformimin e FSK-së në ushtri. Limaj ka falënderuar deputetët e Kuvendit të Kosovës që u dhanë mbështetje këtyre ligjeve. "Forca e Sigurisë së Kosovës do të ofrojë siguri për të gjithë qytetarët pa dallim etnie dhe do t'i kontribuojë paqes dhe sigurisë në rajon", ka shkruar Limaj në llogarinë e tij në "Facebook".

## Misioni i ri i FSK-së

Pas miratimit në lexim parë të tri projektligjeve për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), në Kuvendin e Kosovës dhe procedurave të tjera ligjore do të përcaktohet edhe misioni i ri i kësaj force. Misioni i ri i FSK-së do të jetë: Mbron integritetin territorial të Republikës së Kosovës; Forcë ushtarake shumëtrajektive e armatosur; FSK-ja vepron brenda dhe jashtë vendit. Misioni aktual i FSK-së është: Ndhmon autoritetet civile në përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore; Kryen shkatërrimin e

mjeteve shpërthyes; Ndhmon në operacionet e mbrojtjes civile. Sa i përket armatimit në posedim të FSK-së, me ligjin aktual thuhet se "Tani Forca e Sigurisë së Kosovës është e armatosur lehtë dhe nuk do të ketë armë të rënda, siç janë tanket, artileria e rëndë apo kapacitetet sulmuese ajrore". Ndërkaq, me Ligjin e ri FSK-ja do të jetë e pajisur me armë dhe sisteme të armatimit, në përputhje me nevojat e FSK-së, për përbushjen e kompetencave dhe detyrave të veta.

## Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes

Hartimi dhe procedimi i Projektligjit për Ministrinë e Mbrojtjes është bërë në kuadër të normave aktuale kushtetuese, ashtu që ky projektligj parasheh që të bëhet riorganizimi dhe kalimi i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ministri të Mbrojtjes në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me qëllim të mbikëqyrjes dhe kontrollit civil demokratik mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ky projektligj parasheh që Ministria e Mbrojtjes ta ketë strukturën e vet organizative që siguron funksionalizimin e plotë dhe përbushjen e përgjegjësisë të saj.

Ministria e Mbrojtjes do të hartojë dhe zbatojë politikat e përgjithshme shtetërore të mbrojtjes në nivelin strategjik si dhe do t'i ushtrojë funksionet e kompetencat e saj në përputhje me Kushtetutën, me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Ministria e Mbrojtjes do të jetë e përbërë nga shërbyesit civilë dhe nga personeli ushtarak i FSK-së. Po ashtu, ky projektligj përcakton në mënyrë të detajuar edhe kompetencat e Ministrisë, kompetencat e ministrit të Mbrojtjes, po ashtu edhe kompetencat e sekretarit të përgjithshëm.

Të gjitha ndryshimet e para para me këtë ligj do të bëhen konform fazave të përcaktuara në rekomandimet e rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë dhe të detajuara në planin gjithëpërfshirës të tranzicionit.

## Projektligji për FSK-në

Hartimi dhe procedimi i këtij projektligji është bërë në kuadër të normave aktuale kushtetuese që i referohen FSK-së, ashtu që ky projektligj parasheh që Forca e Sigurisë së Kosovës të zhvillohet si një forcë me kompetenca të reja, organizim dhe funksionim të ri, si mekanizëm i sektorit të sigurisë me detyra të mbrojtjes së integritetit territorial, qyte-

tarëve, pronës dhe interesave të Republikës së Kosovës.

Përkatesisht: Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës përcakton kompetencat, organizimin dhe funksionimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës si forcë shumëtrajektive, profesionale, e armatosur dhe e autorizuar për të shërbyer në vend dhe jashtë vendit, në pajtim me mandatin e dhënë kushtetues dhe ligjor, në mbrojtje të integritetit territorial, qytetarëve, pronës dhe interesave të Republikës së Kosovës, e cila i nënshtrohet kontrollit civil demokratik.

Është me rëndësi të theksohet se në momentin e krijimit të kushteve të favorshme politike vendimmarrëse, procesi i evoluimit dhe transformimit të FSK-së do t'i ndjekë procedurat e ndryshimeve përkatese kushtetuese.

## Projektligji për Shërbim në FSK

Hartimi dhe procedimi i këtij projektligji është bërë në kuadër të normave aktuale kushtetuese që i referohen FSK-së.

Projektligji për Shërbimin në FSK me dispozitat e veta rregullon kushtet e përgjithshme të shërbimit në Forcën e Sigurisë së Kosovës si një shërbim i ndërtuar mbi bazën e parimit të ligjshmërisë, profesionalizmit, komandës, disiplinës, respektit, nderit, ruajtjes së informacionit, komunikimit, jodiskriminimit dhe mundësive të barabarta, paanshmërisë politike, transparencës dhe llogaridhënies.

Ky projektligj përcakton:

- kriteret e përgjithshme për shërbim,

- parametrat e shërbimit,  
- kohëzgjatjen e shërbimit,  
- zhvillimin e karrierës,  
- ndërprerjen e shërbimit,  
- statusin e pjesëtarit të FSK-së,

- të drejtat dhe detyrimet e pjesëtarëve dhe çështje të tjera në kuadër të shërbimit në FSK. Në parim të tri Projektligjet: Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës u aprovuan nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

# A



këto ligje, por kemi çfarë të punojmë në mes të dy leximeve. Mos e kuptoni mbështetjen tonë si një mbështetje qorre, të shtyrë nga retorika e ditës dhe të shtyrë nga entuziazmi. Po, ekziston entuziazmi, ekziston edhe gëzimi ynë që po e bëjmë një hap më tutje, por duhen amandamentuar shumë nene e paragrafë të këtyre ligjeve në përgjithësi" ka thënë Selimi.

Lista Serbe ka kundërshtuar projektligjet për FSK-në dhe në shenjë proteste ka lëshuar seancën.

Deputeti i Listës Serbe, Igor Simiq, ka thënë se ky transformim është në kundërshtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe akteve të tjera ndërkombëtare. "Këto ligje nuk janë kundër serbëve, por edhe kundër shqiptarëve", ka thënë Simiq.





# Kuvendi ratifikon marrëveshjet për sigurime sociale me Zvicrën dhe Belgjikën

Marrëveshjet e ratifikuara u mundësojnë qytetarëve të Kosovës të cilët kanë punuar në Zvicër apo Belgjikë, që pas arritjes së moshës së pensionimit të kenë të drejtë që këtë pension ta marrin në Kosovë si dhe do t'u mundësohet e drejta për t'i bashkuar periudhat e kontributeve në mënyrë që ta realizojnë pensionin



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 TETOR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës të enjten votuan ratifikimin e dy marrëveshjeve në fushën e sigurimeve sociale, ajo me Konfederatën e Zvicrës dhe Mbretërinë e Belgjikës, gjë që mundëson që shumë shpejt qytetarët tanë që kanë punuar në këto shtete, të nisin t'i gëzojnë pensionet kontributpaguese, pensionin bazik të moshës, pensionet familjare dhe invalide të punës. Ministri i Punës dhe Mirëqenies

Sociale, Skender Reçica, para deputetëve ka thënë se këto marrëveshje janë jetike dhe prekin drejtpërdrejt qytetarët e Republikës së Kosovës dhe se nënshkrimi i tyre është pritur me padurim nga qytetarët tanë të cilët kanë derdhur djersën e tyre për të kontribuar jo vetëm për familjet e tyre, por edhe për ekonominë e Kosovës.

Të dyja marrëveshjet ishin nënshkruar këtë vit nga ministri Reçica dhe përfaqësues të shteteve respektive. "Gjatë periudhës prej se që jam mandatuar

ministër i MPMS-së çështjen e marrëveshjeve për sigurime sociale e kam vënë në top prioritetet e Ministrisë, sidomos marrëveshjen me Zvicrën, duke ditur se që nga viti 2010 një e tillë ishte ndërprerë dhe qytetarët tanë nuk kanë mundur t'i realizojnë të drejtat e veta", ka thënë ministri Reçica.

Pas ratifikimit të këtyre marrëveshjeve nga deputetët, ministri Reçica ka përgëzuar qytetarët që do të përfitojnë nga këto marrëveshje të rëndësishme. Marrëveshjet e ratifikuara u mundësojnë qytetarëve të Kosovës të cilët kanë punuar në Zvicër apo Belgjikë, që pas arritjes së moshës së pensionimit të kenë

të drejtë që këtë pension ta marrin në Kosovë si dhe do t'u mundësohet e drejta për t'i bashkuar periudhat e kontributeve në mënyrë që ta realizojnë pensionin, në rastet kur nuk është e mundur t'i plotësojnë kushtet ligjore për pensionim qoftë në Kosovë, apo Zvicër ose Belgjikë.

## Paralajmërohet themelimi i Odës Ekonomike të Diasporës

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 TETOR - Java me bizneset e diasporës shqiptare mbledhi 300 afaristë në Prishtinë nga anembanë bota. Duke nisur nga Kanadaja e deri në Australi, afaristët shqiptarë u pritën në një sesion bashkëbisedues nga krerët institucionalë të shtetit të Kosovës.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, zëvendëskryeministri Dardan Gashi dhe Fatmir Limaj, ministri Endrit Shala dhe Valdrin Llluka, bashkëbiseduan me afaristë të suksesshëm të diasporës sonë, në mesin e të cilëve dhe Lazim Destani, Kryetar Nderi i Rrjetit të Bizneseve të Diasporës Shqiptare dhe Nazmi Viqa, kryetar i Unionit të Bizneseve të Diasporës Shqiptare në Gjermani, të cilët paralajmëruan përfundimin e procedurave për themelimin e Odës Ekonomike të Diasporës, një organizatë e cila është diskutuar tashmë një kohë



të gjatë si projekt i rëndësishëm. Zëvendëskryeministri dhe ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, gjatë fjalës përshëndetëse ka theksuar se promotori i zhvillimit ekonomik është diaspora dhe se Kosova duhet ta rrisë bashkëpunimin me bashkatdhetarët tanë në mënyrë që bizneset e tyre të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit. "Pas pavarësimit ne kemi menduar që investimet e huaja do të jenë

motor i zhvillimit por, në fakt, jeni ju pjesëtar të diasporës sonë. Qëllimi i këtij takimi sot është se si të përmirësohet bashkëpunimi në mes të institucioneve dhe afaristëve nga diaspora. Ju ftojme të merrni pjesë edhe në procesin e privatizimit, ndërsa lobimi juaj te ne të jetë më i fortë dhe më konkret. Nëse ne si institucione marrim detyrat tona që investimet të jenë të sigurta, nuk kemi kryer punën tonë", ka thënë Gashi.

Ndërsa presidenti Hashim Thaçi ka thënë se Kosova ka një klimë të përshtatshme për të bërë biznes. "Ne u jemi mirënjohës bashkatdhetarëve tanë të cilët investojnë në vendin e tyre dhe falë tyre Kosova arrin të ketë një imazh të mirë në botë", është shprehur Thaçi. I pranishëm në javën e Bizneseve të Diasporës Shqiptare ishte edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës do të jetë çdoherë përkrah diasporës dhe se

do të eliminohej barrierat që kanë ata për të investuar në Kosovë. "Kosova ka mundësi të jashtëzakonshme që investitorët nga diaspora ta gjejnë interesin ekonomik për ta zhvilluar e fuqizuar vendin. Si Qeveria e Kosovës po përpiqemi ta eliminojmë çdo procedurë burokratike që bashkatdhetarët tanë ta kenë më të lehtë për të investuar", ka deklaruar Limaj.

Në javën e bizneseve të diasporës shqiptare mori pjesë edhe ministri i Diasporës i Shqipërisë, Pandeli Majko. Gjatë fjalimit ai ka potencuar se shqiptarët janë në ditët më të mira si komb. "Është kaluar nga mbijetesat në normalitet. Unë i inkurajoj bizneset nga diaspora që ta investojnë kapitalin në Kosovë dhe në të gjitha trojet shqiptare", ka thënë Majko. "Java me bizneset e diasporës shqiptare" vazhdon aktivitetet edhe sot (e premte), ku do të bëhet listimi i kërkesave nga bizneset e diasporës dhe përgatitja e rekomandimeve për institucionet.

## Rektori Bajraktari zgjedhet nënkryetar i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve

PRIZREN, 18 TETOR (ER) - Rektori i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), prof. dr. Agron Bajraktari, është zgjedhur nënkryetar i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, institucion ky i pavarur që mbikëqyrë kualifikimet kombëtare. Rektori

Bajraktari do të jetë pjesë udhëheqëse në mandatin katërvjeçar të këtij Këshilli, i cili numëron 13 anëtarë që përfaqësojnë ministrinë, organizatat e partnerëve shoqërorë dhe universitetet.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka për mision ta mbikëqyrë dhe zhvillojë Kornizën

Kombëtare të Kualifikimeve në kontekst të të mësuarit gjatë gjithë jetës në partneritet me nxënësin/kandidatin, punëdhënësin dhe ofruesit e arsimit dhe aftësimin në të gjitha nivelet dhe në përputhje me nevojat dhe kërkesat e shoqërisë dhe ekonomisë.





E mbijetuara e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, Vasfije Krasniqi-Goodman, është pritur nga krerët shtetërorë

## Kosova e nderon Vasfije Krasniqin-Goodman

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka dhënë titullin "Qytetar i Merituar i Republikës së Kosovës" Vasfije Krasniqin-Goodman, e cila i ka mbijetuar dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Presidenti ka deklaruar se Vasfija është heroinë e gjallë, duke e falënderuar atë për guximin dhe trimërinë e jashtëzakonshme që ka treguar me rrëfimin e saj për të vërtetën e asaj se çfarë ka ndodhur në Kosovë në vitet '98-'99

EPOKA  
ERE

Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 18 TETOR** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka nderuar të enjten të mbijetuarën e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, Vasfije Krasniqin-Goodman, duke i dhënë titullin "Qytetar i Merituar i Republikës së Kosovës". Me këtë rast, shefi i shtetit ka thënë se të mbijetuarat e dhunës seksuale kanë nevojë për përkrahjen e tërë shoqërisë sonë. Ai ka theksuar se një nga brengat më të dhimbshme janë rastet e dhunimit të rreth 20 mijë grave dhe burrave shqiptarë nga forcat paramilitare dhe militare të Serbisë. "Sot është një nga momentet më rrëqethëse në jetën time. Për mua Vasfija është heroinë e gjallë. Unë e falënderoj për guximin dhe trimërinë e jashtëzakonshme që ka treguar me rrëfimin e saj për të vërtetën e asaj çfarë ka ndodhur në Kosovë në vitet '98-'99, për gjenocidin, spastrimin etnik, vrasjet dhe dhunimet. Është një rast i pashembullt dhe një rrëfim që thërret ndërgjegjen edhe në Kosovë, por duhet ta thërrasë ndërgjegjen edhe të popullit serb

dhe ndërgjegjen e drejtësisë ndërkombëtare, sepse e vërteta po thuhet, por drejtësia nuk po zbatohet", ka thënë presidenti Thaçi. Ai ka thënë se populli i Kosovës ka përjetuar çaste shumë të rënda në periudhën e luftës, në rastet e tragjedi dhe masakrave të policisë dhe ushtrisë serbe kundër popullatës civile.

Ndërsa e mbijetuara e dhunës seksuale në luftën e Kosovës, Vasfije Krasniqi-Goodman, në emër të të gjithave grave të dhunuara e ka falënderuar presidentin Thaçi për përkrahjen dhe dekoratën si dhe ka kërkuar mbrojtje dhe drejtësi juridike. E mbijetuara e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, Vasfije Krasniqi-Goodman, të enjten është pritur edhe nga kryeministri Ramush Haradinaj. Ky i fundit ka thënë se Krasniqi-Goodman ka mposhtur heshtjen dhe ka dalë kundër aktit më çnjerëzor, duke u bërë model i shoqërisë për të guxuar. "Vasfije Krasniqi mposhti heshtjen dhe u kryengrit kundër aktit më çnjerëzor, duke u bërë model i shoqërisë sonë për të guxuar. Ajo i dha zë të vërtetës dhe forcë për t'u dëshmuar të gjitha

viktimize të dhunës seksuale gjatë luftës. Rrëfimi i saj, si pasqyra më reale e përjetimeve tragjike të popullit tonë, është shtysë e fuqishme për ngadhënjimin e drejtësisë dhe që ta njohë bota të vërtetën e Kosovës. Mëngjesin e sotëm këtë grua të jashtëzakonshme e përgëzova për guximin e përmasave heroike. Të gjitha viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës e kanë tërë mbështetjen tonë dhe asnjëherë nuk duhet të ndihen vetme në këtë betejë për drejtësi", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook".

Vasfije Krasniqi Krasniqi-Goodman në fillim të javës ka thyer heshtjen duke u bërë femra e parë në Kosovë që publikisht ka folur dhe ka rrëfyer gjithë tmerrin

që ka përjetuar në prillin e vitit 1999. Si 16 vjeçe, në prill të vitit 1999, ajo ishte rrëmbyer nga shtëpia e vet në fshatin Stanoc i Ulët të Komunës së Vushtrrisë nga një person i uniformuar dhe ishte dhunuar seksualisht në dy lokacione të ndryshme në Babimoc, nga dy persona të ndryshëm.

Në vitin 2012 për këtë çështje ishte ngritur një aktakuzë nga Prokuroria Speciale e Kosovës. Sipas aktakuzës së Prokurorisë, Jovica Dejanoviq dhe Gjorgje Bojkoviq ishin akuzuar për krime lufte kundër popullatës civile, përkatësisht dhunimin e Vasfije Krasniqi.

Gjykata Themelore e Mitrovicës, e përbërë nga tre gjyqtarë të

EULEX-it në vitin 2013, i kishte liruar të akuzuarit. Me pas prokuroria ishte ankuar ndaj këtij vendimi dhe pas kësaj ankese, Gjykata e Apelit kishte vërtetuar fajësinë e Jovica Dejanoviqit dhe Gjorgje Bojkoviqit për krime të luftës. Jovica Dejanoviq ishte dënuar me 12 vjet burgim, ndërsa Gjorgje Bojkoviq me 10 vjet burgim. Ndaj këtij vendimi të Apelit ishin ankuar avokatët mbrojtës të të akuzuarve, dhe Gjykata Supreme kishte anuluar vendimin e Apelit dhe kishte liruar dy të akuzuarit. Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, i cili kishte monitoruar gjithë procesin gjyqësor, ka konstatuar se në tërë këtë proces gjyqësor ishin evidentuar shkelje të mëdha.

## MAShT-i pritet të dalë me strategji kombëtare për arsimin e lartë

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në tryezën për arsimin e lartë në vend, ka theksuar të enjten se diskutimet e përbashkëta në një tryezë të nivelit kombëtar, e cila do të ketë në përbërje ekspertë të arsimit të lartë, do të ishte mundësia më e mirë për të dalë me një strategji kombëtare për arsimin e lartë në Kosovë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 18 TETOR** - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka organizuar tryezën për arsimin e lartë në Kosovë, e cila është ndihmuar nga USAID-i, World Learning dhe Programi TLP-SP. Në këtë tryezë kanë marrë pjesë ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë të arsimit, përfaqësues të USAID-it, përfaqësues të Zyrës së BE-së në Kosovë, përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë dhe të shoqërisë civile.

Ministri Bytyqi me këtë rast ka falënderuar USAID-in që vazhdimisht e ka përkrahur këtë ide dhe ka ndihmuar që të vijmë deri këtu që të krijohet një tryezë e rrumbullakët dhe të diskutohet për pjesën shumë të rëndësishme të sistemit arsimor, pra për arsimin e lartë. "Forma që e kemi zgjedhur me partnerët në diskutimet e përbashkëta që ta kemi një tryezë të rrumbullakët në nivel kombëtar, e cila do të ketë në përbërje ekspertë të arsimit të lartë, do të ishte mundësia më e mirë që të dalim me një strategji kombëtare për arsimin e lartë në Kosovë", ka



thënë ministri Bytyqi.

Ministri Bytyqi ka pohuar se Kosova e ka pasuri të madhe rininë, prandaj ka theksuar se duhet të kujdesemi që për këtë kapital të madh të krijojmë mundësi dhe institucione, në mënyrë që këtë pasuri ta shfrytëzojmë ashtu siç duhet. "Shfrytëzimi më i mirë i kësaj rinie është që ne t'i ofrojmë një edukim të mirëfilltë, veçanërisht kur flasim për pjesën më të rëndësishme të edukimit të tyre, pra për arsimin e lartë, që këta të

rinj të bëhen më pas edhe bartës të proceseve të zhvillimit të vendit tonë", ka deklaruar Bytyqi.

Ministri ka thënë se në këtë tryezë mund të inkuadrohen edhe aktorë të tjerë dhe në fund të rezultojë me një dokument që do të hapë një perspektivë tjetër për sistemin e arsimit të lartë në Kosovë. Ai ka theksuar se do të jetë gjithmonë në dispozicion për t'i dëgjuar mendimet dhe për t'i shtyrë ato përpara. Ndërsa Paul Vaca, përfaqësues i USAID-it në Kosovë, ka falën-

deruar ministrin Bytyqi për vizionin që ka pasur për këtë nismë, për të cilën tha se është shumë e rëndësishme për të ardhmen e arsimit të lartë në Kosovë. "Kam shpresë se debati që do të gjenerohet në këtë tryezë të rrumbullakët do të vazhdojë të ketë qasje të hapur në mënyrë që të arrijmë të krijojmë një strategji e cila shikon drejt së ardhmes, e cila promovon llogaridhënien dhe e cila u përgjigjet nevojave të rinisë së Kosovës", ka deklaruar Vaca.

Ndërkaq Carl Hammerdorfer nga Programi TLP-SP po ashtu ka falënderuar ministrin Bytyqi dhe ka thënë se ky grup do të merret me të gjitha institucionet që përgatisin të rinjtë për tregun e punës. Po ashtu, për rëndësinë e kësaj tryeze ka folur edhe William Trigg nga USAID-i, i cili ka theksuar se është koha të lëmë anash skepticizmin dhe të punojmë së bashku që të ndërtojmë një sistem pozitiv të arsimit për të ardhmen e Kosovës.



# Sektori i minierave, në fokus të investitorëve kanadezë

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 TETOR - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Kanadasë, jorezident në Kosovë, Daniel Maksymiu, me të cilin kanë diskutuar për zhvillimet në vend, si: për energjinë, teknologjinë e informacionit, me theks të veçantë për sektorin minerar.

Fokus kryesor i takimit ishte potenciali minerar që ofron Kosova. Me këtë rast ministri Lluka e ka njoftuar ambasadorin për zhvillimet e fundit për Trepçën, për krijimin e bordit, finalizimin e statutit si dhe studimin e fizibilitetit i cili është duke u zbatuar. "Që nga takimi ynë i fundit janë bërë zhvillime pozitive për sa i përket ndërmarjes së Trepçës, është krijuar bordi, është finalizuar statuti dhe studimi i fizibilitetit është duke u zbatuar. Pasi të finalizohet gjithçka në

Trepçë do të donim të shihnim më shumë kompani kanadeze në të", ka thënë ministri Lluka.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për mundësitë e investimeve kanadeze në sektorin e teknologjisë informatike dhe komunikuese, po ashtu edhe në sistemin e ujitjes, ku kreu i MZHE-së tha se mirëpret investimet kanadeze në këta sektorë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit.

Në fund të takimit ambasadori kanadez ka thënë se është i kënaqur që ka përparime në sektorin minerar dhe tha se investitorët kanadezë do të fokusohen edhe në sektorë të tjerë. "Ne jemi të gëzuar për këto zhvillime pozitive të cilat kanë ndodhur gjatë kësaj kohe, sidomos në atë minerar. Ky do të jetë një lajm shumë i mirë për investitorët kanadezë. Ne duam ta zhvillojmë edhe më tej bashkëpunimin dhe do t'i shohim mundësitë e sjelljes së investitorëve potencialë në



Kosovë përmes agjencive kanadeze të eksportit", është shprehur ambasadori Daniel

Maksymiu. Ministri Lluka ka falënderuar ambasadorin kanadez Daniel Maksymiu, duke

thënë se bashkëpunimi mes të dy vendeve do të thellohet edhe më shumë.

## Pa teknologjinë e fundit të filtrave nuk jepet leja për termocentralin 'Kosova e Re'

OBILIQ, 18 TETOR (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, ka marrë pjesë të enjten në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën", që është realizuar në Komunën e Obiliqit. Ministri Matoshi, së bashku me kryetarin e Obiliqit, Xhafer Gashi, kanë vizituar njërin nga deponitë ilegale të mbeturinave në këtë komunë, e cila gjatë këtij aksioni është pastruar dhe do të shndërrohet në park për banorët e Obiliqit. Me këtë rast, ministri Matoshi ka thënë se Komuna e Obiliqit është prioritet i Qeverisë së Kosovës për shkak të ndotjes së ajrit që shkaktohet nga termocentralet. "Jemi duke bashkëpunuar me KEK-un dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik për vendosjen e filtrave të ri në 'Kosovën B'. Është një donacion nga Komisioni Evropian mbi 70 milionë euro dhe shpresojmë se shumë shpejt do të vendosen filtrat në 'Kosovën B'. Jemi të përkushtuar dhe të vendosur që



pa teknologjinë e fundit të filtrave të mos japim leje ndërtime

more dhe leje mjedisore për termocentralin 'Kosova e Re', ka

deklaruar ministri Matoshi. Ai ka bërë me dije se MMPH-ja

është e fokusuar ta ndalojë edhe shitjen e thëngjillit në mënyrë ilegale.

Ndërsa kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka falënderuar ministrin Matoshi për mbështetjen e dhënë për përmirësim të mjedisit, ndërsa ka treguar se kjo komunë ka larguar 19 deponi ilegale. "Ne e kemi në fokus çështjen e ambientit në vazhdimësi, duke u bazuar që në komunën tonë janë ndotësit më të mëdhenj në Kosovë, po përpiqemi që deponitë inerte, deponitë ilegale t'i eliminojmë me qëllim që t'i shndërrojmë në pjesë të gjelbëruara", ka deklaruar Gashi.

Aksionit për pastrimin e Komunës së Obiliqit i është bashkangjitur edhe drejtori i Shërbimeve të KEK-ut, Edmond Nulleshi, si dhe vullnetarë nga organizata "Let's do it Kosova". Aksioni "Ta pastrojmë Kosovën" ka filluar më 15 shtator, kurse do të përfundojë më 15 dhjetor të këtij viti.

## Imeri e njofton ambasadorin gjerman me punën e ATK-së

PRISHTINË, 18 TETOR (ER) - Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Sakip Imeri, ka pritur në takim ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt. Në këtë takim Imeri e ka njoftuar ambasadorin Heldt për zhvil-

limet dhe aktivitetet e ATK-së, të cilat deri më tani kanë pasur performancë të lartë. Po ashtu, drejtori Imeri ka falënderuar ambasadorin e Gjermanisë për bashkëpunimin e deritanishëm me organizatën GIZ, e cila administratën tatimore e ka

mbështetur për ngritjen e kapaciteteve njerëzore, për zhvillimet e tjera institucionale, duke ndihmuar ngritjen e njësjive organizative dhe modernizimin e disa proceseve të punës të cilat kanë influencë të madhe për arritjen e synimeve të ATK-së.





# Telekomi i Kosovës shton 500 konsumatorë të rinj në Prizren



Nënshkrimi i kësaj kontrate në mes të Telekomit të Kosovës dhe Komunës së Prizrenit do të mundësojë ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile, fikse, internetit dhe IPTV-së, duke përmbushur nevojat e shtuara për komunikim të shpejtë, njëkohësisht duke shtuar numrin e konsumatorëve të rinj

**PRIZREN, 18 TETOR (ER)** - Mbi 500 konsumatorë të rinj që përbëjnë tërë administratën në nivelin komunal të Prizrenit tash e tutje do të jenë përfitues të shërbimeve telekomunikuese të Telekomit të Kosovës. Kjo u bë e mundur të enjten pas

nënshkrimit të kontratës për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese për Kuvendin Komunal të Prizrenit në mes të kryeshefit ekzekutiv të Telekomit të Kosovës, Gent Begolli, dhe kryetarit të kësaj komune, Mytaher Haskuka.

Të gjithë punonjësit e Komunës së Prizrenit, si dhe personeli mjekësor dhe administrativ i nëntë qendrave të mjekësisë familjare të kësaj komune, nga dita e enjte do të mund të komunikojnë më shumë, por me shpenzime më të ulëta, pasi pakot e përzgjedhura janë shumë atraktive dhe më të favorshme që mundësojnë dhe lehtësojnë këtë komunikim. "Pas shumicës së komunave që tashmë dihet që i janë bashkuar VALA-s dhe kanë në shfrytëzim shërbimet dhe produktet e reja të saj, sot nënshkruam me Komunën e

Prizrenit për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese që, përveçse do ta lehtësojë komunikimin e punonjësve komunalë dhe personelit shëndetësor, gjithashtu është edhe një tjetër dëshmi se Telekomit të Kosovës edhe më tutje mbetet operatori më i preferuar i telefonisë dhe internetit në vendin tonë", ka thënë kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Gent Begolli. Nënshkrimi i kësaj kontrate do ta mundësojë ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile, fikse, internetit dhe IPTV-së, duke përmbushur nevojat e shtuara për

komunikim të shpejtë, njëkohësisht duke shtuar numrin e konsumatorëve të rinj. "Siç dihet, Telekomit të Kosovës ofron shërbime cilësore, aq më mirë kur këto shërbime ofrohen edhe për të gjithë në komunë duke krijuar mundësi të shumta të komunikimit që na ndihmojnë për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi ndaj qytetarëve tanë, sepse përgjegjësia ndaj qytetarëve është e lidhur ngushtë pikërisht me efikasitetin kohor që mundësohet përmes teknologjisë së shpejtë", është shprehur kryetar i Prizrenit, Mytaher Haskuka.

## Ratifikohet marrëveshja e 2.4 milionë eurove në mes të Ministrisë së Inovacionit dhe GIZ-it



**PRISHTINË, 18 TETOR (ER)** - Me propozim të ministrit të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, të enjten në Kuvendin e Kosovës është votuar Ligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe GIZ për bashkëfinancimin e Projektit "Creating Employment Through

Export Promotion" (CETEP). Projekti "Krijimi i vendeve të punës përmes promovimit të eksportit" është bashkëfinancim në mes të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe GIZ-it gjerman, me vlerë 2.4 milionë euro, nga të cilat 1.2 milion ndahen nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, ndërsa 1.2 milion të tjera nga

GIZ-i. Me rastin e votimit në Kuvend të këtij ligji, ministri Beqaj ka deklaruar se projekti CETEP ka vlerë 4.2 milionë euro dhe do të shërbejë për përkrahjen e sektorit privat, prodhimit, eksportit dhe grave në biznes. Ai ka thënë se me këtë projekt do të rriten fondet për përkrahje të sektorit privat në fushën e inovacionit

dhe ndërmarrësisë. Po ashtu, ministri Beqaj ka theksuar se me qëllim të rritjes së kredibilitetit të procesit të ndarjes së fondeve, të gjitha procedurat e projektit do të ekzekutohen nga GIZ-i, me qëllim të rritjes së kredibilitetit dhe dyfishimin e mjeteve financiare. Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në kuadër të

aktiviteteve për përkrahje të sektorit privat, në fushën e inovacionit, teknologjisë dhe ndërmarrësisë, në vazhdimësi po gjen përkrahje edhe të partnerëve ndërkombëtarë, për realizimin e objektivave për fuqizimin e ekonomisë digjitale, për rritjen e punësimit dhe për avancimin e shërbimeve të ndërmarrjeve të Kosovës.



## Gjilani nis rregullimin e shëtitorës mbi Lumin 'Mirusha'

**GJILAN, 18 TETOR (ER)** - Në qendër të qytetit të Gjilanit, mbi lumin "Mirusha", ka filluar projekti për rregullimin e shëtitorës, i cili ka për qëllim interesin e banorëve dhe biznesit privat. "Sot po fillojnë punimet në Lumin 'Mirusha', në pjesën jugore të zonës urbane të Gjilanit, për rregullimin e pjesës tjetër të shëtitorës dhe do ta vazhdojmë financimin deri në përfundimin e plotë të këtij projekti. Kjo do të jetë shëtitoreja më e gjatë në Komunën e Gjilanit e cila nuk është për qarkullim të veturave, por është e dedikuar për njerëz dhe për shfrytëzim nga ana e bizneseve", ka thënë kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, gjatë

fillimit të këtij projekti. Ai ka thënë se lumi "Mirusha" tashmë nuk do të jetë qendër e kundërmimit. "Ky lumë tashmë nuk do të jetë qendër e kundërmimit sepse jemi duke punuar që kjo shëtitore të shfrytëzohet edhe për zhvillim të sektorit privat dhe për kushte më të mira për banorët që jetojnë këtu dhe për të gjithë njerëzit në përgjithësi", ka thënë Haziri.

Kryetari i Gjilanit pret që ky projekt të përfundohet para vitit të ri dhe për festa të shfrytëzohet edhe kjo hapësirë, derisa ka bërë me dije se për vitin e ardhshëm një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet mirëmbajtjes së projekteve të realizuara.



## 'Buçaj' dhe Komuna e Mitrovicës do t'i ndërtojnë pesë shtëpi për familjet skamnore

**MITROVICË, 18 TETOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri dhe nënkryetari Faruk Mujka kanë pritur në një takim përfaqësuesin e kompanisë "Buçaj" nga Prishtina, Fatmir Krasniqi, me bashkëpunëtorë, me të cilin kanë biseduar për realizimin e projektit për ndërtimin e pesë shtëpive për strehimin e familjeve skamnore nga Mitrovica që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.

Drejtnesit e komunës e kanë njoftuar përfaqësuesin e kompanisë "Buçaj" me përgatitjet e deritashme për realizimin e projektit të lartpërmendur që do të financohet nga kjo kompani.

Kryetari Bahtiri ka falënderuar kompaninë "Buçaj" për vendimin e saj që ta realizojë këtë projekt humanitar në Mitrovicë. "Vendimi dhe gatishmëria juaj për ta ndihmuar Mitrovicën në zgjidhjen e problemeve të strehimit për personat me gjendje të vështirë ekonomiko-sociale, është mirëpritur nga të gjitha institucionet komunale, drejtuesit e tyre dhe qytetarët e Mitrovicës", ka thënë Bahtiri. Ai e ka njoftuar Krasniqin se Komuna e Mitrovicës tashmë e ka ndarë hapësirën e nevojshme për ndërtimin e shtëpive. "Tashmë gjithçka është në rregull. Përgatitjet janë bërë të gjitha dhe

ne mund të fillojmë që sot me realizimin e projektit", ka thënë Bahtiri.

Ndërsa përfaqësuesi i kompanisë "Buçaj", Fatmir Krasniqi, ka thënë se vizita e tij në Mitrovicë kishte për qëllim që të mësojë saktësisht se si qëndron puna lidhur me përgatitjet për fillimin e realizimit të projektit. "Ne jemi të lumtur që kemi mundësinë që ta ndihmojmë sadopak Mitrovicën me këtë projekt humanitar. Edhe ne jemi të gatshëm për fillimin e ndërtimit të shtëpive, kështu që do t'ju njoftojmë saktësisht për ditën kur së bashku do ta vendosim gurtëmelin për realizimin e projektit", ka thënë Krasniqi.



## Gashi kërkon nga Matoshi mbështetje në fushën e ambientit

**KASTRIOT, 18 TETOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Kastriotit, Xhafer Gashi, ka pritur në takim ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, me të cilin ka diskutuar për shumë çështje që e shqetësojnë këtë komunë dhe qytetarët në fushën e ambientit dhe mbrojtjen e tij. Gashi ka treguar se me Matoshin kanë diskutuar edhe për projektet dhe investimet që janë duke u bërë në fushën e mjedisit në këtë komunë dhe për Ligjin për Kastriotin. "Projektet dhe investimet që

janë duke u bërë në fushën e mjedisit me parqet dhe hapësirat e gjelbëruara, bashkëpunimi me KEK-un dhe mbështetja e tyre, fokusi i vitit 2019 me buxhetin e Ligjit për Obiliqin me mbi 2 milionë euro në fushën e ambientit, ishin disa prej temave që shtjellova me z. Matoshi, nga i cili kërkoja mbështetje dhe bashkëpunim duke njohur specifikat që kemi në ambient si komunë industriale që jemi. Edhe ministri Matoshi u zotua për mbështetje karshi komunës me caq shumë atakime në fushën e ndotjes së

ambientit", ka thënë Gashi. Pas takimit, Gashi dhe Matoshi kanë vizituar disa vende të cilat janë pastruar gjatë aksionit "Ta pastrojmë Kosovën". "Vizituam vendet në terren, me ç'rast falënderova përzemërsisht DMM-në, vullnetarët, nxënësit, qendrat rinore, OJQ-të, shkollat dhe institucionet shëndetësore, deponinë në Mirash, me theks të veçantë KEK-un për punën e madhe që po e bëjnë tani e një muaj për largimin e deponive ilegale (inerte) si dhe për pastrimin e komunës në përgjithësi", ka thënë Gashi.

## Disa shkolla në Malishevë përfitojnë donacion nga Gjermania

**MALISHEVË, 18 TETOR (ER)**

- Komuna e Malishevës ka një bashkëpunim disaveçar me Komunën e Soestit nga Gjermania. Ky bashkëpunim vazhdon edhe tash mes institucioneve, përkatësisht kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begajt, dhe kryetarit të Komunës së Soestit, Manfred Witer në Gjermani. Këtë lidhje bashkëpunimi e forcojnë çdo ditë e më shumë mërgimtarët tanë si Nuha Krasniqi dhe përfaqësues nga Shoqata e Unitetit Global Shqiptar (ShUGSh).

Falë këtij bashkëpunimi disa shkolla të Komunës së Malishevës janë inventarizuar me inventar shkollor si me banka, karrige, kompjuterë, harta shkollore, printerë, dhe pajisje të tjera shkollore, të cilat do të ndahen për institucionet arsimore në Komunën e Malishevës, e kryesisht për Gjymnazin "Hamdi Berisha" dhe




ShFMU "Ibrahim Mazreku" në Malishevë.

Ky donacion me inventar shkollor është realizuar nga përkrahja e kryetarit të Komunës së Soestit, Manfred Witter, nga kontributi i mërgimtarit Nuha Krasniqi dhe Shoqata Uniteti Global Shqiptar. Përmbajtja e inventarit është 232 karrige, 532 banka, 28 kompjuterë, 12 banka për mësues, 1 printer, 24 tastiera, 35 monitor, dhe 10 harta shkollore. Po ashtu, këto ditë kryetari Begaj, në shoqërim me drejtorin e Qendrës së Kompetencës "Kujtim Krasniqi", realizuan disa vizita nëpër institucione arsimore profesionale, administrative, në qytetin e Soestit, ku shkëmbyen përvoja pune.



# Fjalori Enciklopedik i Kosovës, fjalor kundërkombëtar



**Rexhep QOSJA**

Fjalori i ashtuquajtur Enciklopedik i Kosovës është përmbledhje dyvëllimëshe që nuk i plotëson kriteret elementare për t'u quajtur vepër profesionale, shoqërore e kombëtare.

Fjalori në fjalën është vepër e konceptuar dhe e përgatitur prej diletantëve të punës shkencore e

punës profesionale.

Në këtë Fjalor nuk çmohen as masa, as kriteri, as parimi, as merita, as vlera, që janë parimet themelore të cilave duhet t'u përmbahen përpiluesit e enciklopevide.

Do parë kush krejt është futur në të dhe do parë kush krejt është lënë jashtë tij për t'u bindur se çfarë injorance e ka konceptuar atë Fjalor.

Do parë cilat institucione të përtashme e cilat institucione historike janë futur në të e cilat janë lënë jashtë tij për të parë çfarë fanatikësh politikë e partiakë e kanë konceptuar atë Fjalor!

Fjalori Enciklopedik i Kosovës është përmbledhje njësisht shkimore, kur e kur shkarravinash, në të cilin cenohet plotësisht dhe qëllimisht njësia e historisë,

e gjeografisë, e kulturës, e qytetërimit shqiptar: e historisë politike, e arteve, e shkencave, e traditës dhe e jetës kombëtare në përgjithësi në historinë dhe në të përtashmen e saj.

Në këtë mënyrë Fjalori në fjalë është bërë përmbledhje e konceptit serb për ndarjen e Kombit shqiptar në dy kombe: në kombin e shqiptarëve të Shqipërisë të quajtur albanci dhe në kombin e shqiptarëve të Kosovës e të ish Jugosllavisë në përgjithësi të quajtur shiptari ose shiftari!

Cenimi i këtyllë i njësisë së Kombit shqiptar e bën Fjalorin në fjalë vepër kundërkombëtare që komprometon vetëdijen historike, shkencore dhe kombëtare të shqiptarëve në përgjithësi, kurse të shqiptarëve

të Kosovës në veçanti!

Fjalori Enciklopedik i Kosovës është fryt i zi i privatizimit partiak të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës! Fjalori Enciklopedik i Kosovës është fryt i zi i privatizimit të kësaj Akademie prej një Klani mafioz!

Fjalori në fjalë është fryt i zi i korrupsionit të pandalshëm e të shumëllojshëm që e ka gllabëruar këtë institucion.

Vizita e djeshme e tre pushtetarëve të lartë të Kosovës në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës tregon se sa janë fundosur dija, vetëdija, drejtësia, ligji, ndërgjegjshmëria në institucionet më të larta të Kosovës: në Presidencën dhe në Qeverinë!

Me praninë e tyre aty ata në të

vërtetë i shpallën të ligjshme edhe privatizimin partiak, edhe privatizimin klanor, edhe korrupsionin, edhe zhvatjet, edhe vjedhjet, edhe krimin në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës sot. Dhe, i shpallën të ligjshme në vend se t'i propozojnë Kuvendit të Kosovës, si financues i asaj Akademie të shpërfytyruar, të degjeneruar, që të marrë masat ligjore për shërimin e për shpëtimin e saj sa më të shpejtë prej gjithë atyre të këqijave që e sundojnë sot!

Deri kur do ta lejojë populli i Kosovës këtë analfabetizëm shkencor e profesional, këtë korrupsion, këtë degjenerim, këtë shfrenim në Akademi dhe në politikën shtetërore të Kosovës?!

*Prishtinë, 16. 10. 2018*

## Ministri Gashi: Strategjia e Kulturës të përfshijë konsultime të të gjithë aktorëve

PRISHTINË, 18 TETOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka takuar grupin punues për Strategjinë e Kulturës, cili do të jetë një dokument i ri strategjik gjithëpërfshirës për këtë fushë. Në grupin punues të përpilimit të këtij dokumenti strategjik për fushën e kulturës do të ketë të përfshirë përfaqësues të organizatave qendrore të kulturës, të nivelit lokal, ekspertë të fushës dhe nga shoqëria civile. Gjithashtu, në faza të ndryshme të procesit do të konsultohen edhe ekspertë ndërkombëtarë. Ministri Gashi ia ofroi përkrah-

jen e plotë të MKRS-së grupit punues.

Ministri u shpreh se strategjia e cila do të hartohet do të jetë dokument që orienton për vlera të mirëfillta krijuese dhe kulturore, me objektiva të arritshme dhe të qarta. "Kultura është një fushë e gjerë dhe ka rëndësinë e pazëvendësueshme në shoqëri. Si ministri do të kemi kujdes të veçantë dhe do të përpiqemi që buxheti për kulturë të rritet edhe më shumë sepse përmes fushës së kulturës mbahet lart shpresa në shoqëri dhe krijohet një imazh edhe për Kosovën brenda dhe jashtë saj", është shprehur ministri Gashi.



## Komuna e Prishtinës i ka borxh ujësjellësit 307 mijë euro



PRISHTINË, 18 TETOR (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit (KRU) "Prishtina" ka njoftuar opinionin se Komuna e Prishtinës si institucion publik nuk paguan për shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit pavarësisht prej përpjekjeve të mëdha të kësaj kompanie që ka bërë për të gjetur zgjidhje përmes kërkesave të shumta për takime lidhur me këtë çështje. "Borxhet e Komunës së Prishtinës (si institucion) për ujë dhe kanalizim janë 307 mijë euro/borxh i institucioneve arsimore (shkolla fillore dhe të mesme dhe kop-

shte publike) dhe nga kjo shumë, veç Kuvendi Komunal i Prishtinës me bashkësitë lokale i ka borxh mbi 9 000 euro. Kjo është vërejtja e fundit publike që po i bëhet këtij institucioni të rëndësishëm. Nëse nuk ndërmarrin hapa konkretë që t'i shlyejnë këto borxhe të mëdha, KRU 'Prishtina' sh. a. së shpejti do të ndërmarrë hapa konkretë, shkyçe nga të gjitha shërbimet dhe masa ligjore përmbare, në të njëjtën mënyrë siç po i trajton edhe konsumatorët e tjerë borxhlinj në sektorin e amvisërisë", është thënë në njoftimin e KRU "Prishtina".



## Periudha transitore pas Brexitit mund të zgjatet

LONDËR, 18 TETOR - Kryeministrja britanike Theresa May ka dhënë shenja të enjten se ajo do ta konsiderojë zgjatjen e të ashtuquajturës periudhë transitore pas largimit të Britanisë nga Bashkimi Evropian, transmeton "Reuters". Kritikët e saj në anën tjetër e kanë konsideruar këtë deklaratë si tradhti ndaj Brexitit.

Në më pak se gjashtë muaj para se Britania të largohet nga blloku evropian, bisedimet për Brexitin kanë ngecur rreth marrëveshjes për kufirin në



mes të provincës britanike, Irlandës Veriore dhe Irlandës. Në një samit të BE-së të mbaj-

tur në Bruksel, disa liderë dhe diplomatë kanë thënë se May nuk ka ofruar asgjë të re, ashtu

që të arrihet ndonjë pikë kthese dhe procesi të vazhdojë në fazat e tjera.

Të dyja palët janë duke synuar ta anashkalojnë krijimin e një kufiri të ashpër irlandez, sepse një gjë e tillë do të ndikonte në tregtinë e të dyja shteteve. "Një tjetër ide që ka lindur përfshin mundësinë e zgjatjes së periudhës së zbatimit të Brexitit për disa muaj, pra do të jetë vetëm periudhë disamujore", ka thënë May para gazetarëve në ditën e dytë të samitit. "Mirëpo ne synojmë të mos shfrytëzojmë këtë mundësi sepse jemi duke punuar që të

kemi një marrëdhënie bashkëpunuese deri në fund të dhjetorit të vitit 2020", është shprehur ajo.

May pati tentuar që në samitin e mbajtur në Bruksel në muaj të parë, të paraqesë një ton më të butë para homologëve të vet britanikë, mirëpo ky takim nuk ka rezultuar me sukses. Po këtë javë May u ka bërë thirrje liderëve evropianë të punojnë së bashku. "Ne kemi treguar se mund të arrijmë së bashku marrëveshje konstruktive. Unë vazhdoj të jem e bindur për një rezultat të mirë", është cituar të ketë thënë May.

## Zyrtarët e lartë amerikanë e kinezë të mbrojtjes takohen në Singapor

Jim Mattis dhe gjenerali kinez Wei Fenghe u takuan në një konferencë aziatike të sigurisë në Singapor, në përpjekje për t'i normalizuar marrëdhëniet ushtarake. Pas bisedimeve, zyrtarët amerikanë thanë se patën përshtypjen që marrëdhëniet me Ushtrinë e Kinës u stabilizuan, ndonëse bisedimet nuk prodhuan marrëveshje të reja

SINGAPOR, 18 TETOR - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Jim Mattis, i tha homologut të vet kinez Wei Fenghe se përmirësimi i marrëdhënieve të nivelit të lartë midis dy vendeve do ta ulë rrezikun e konfliktit të paqëllimtë. Jim Mattis dhe gjenerali kinez Wei Fenghe u takuan në një konferencë aziatike të sigurisë në Singapor, në përpjekje për t'i nor-

malizuar marrëdhëniet ushtarake. Pas bisedimeve, zyrtarët amerikanë thanë se patën përshtypjen që marrëdhëniet me Ushtrinë e Kinës u stabilizuan, ndonëse bisedimet nuk prodhuan marrëveshje të reja. Marrëdhëniet ushtarake midis Uashingtonit dhe Pekinit u përkeqësuan gjatë javëve të fundit lidhur me luftën e hidhur



tregtare, sanksionet e ShBA-së kundër Ushtrisë së Kinës për blerjen e armëve nga Rusia dhe për krijimin e avanposteve ushtarake të Pekinit në Detin e Kinës Jugore.

Zyrtari i Pentagonit Randall Schriver u tha gazetarëve se sekretari Mattis "përsëriti dëshirën amerikane për marrëdhënie të qëndrueshme që është një forcë stabilizuese në marrëdh-

hëniet e përgjithshme".

Sekretari Mattis planifikoi të takohej në Pekin me ministrin kinez Wei disa javë më parë, por zyrtarët kinezë thanë se Wei nuk ishte në dispozicion, një nga treguesit se tensionet në marrëdhëniet ShBA - Kinë ishin shtrirë edhe në fushën ushtarake.

Presidenti Donald Trump shpesh e ka kritikuar Kinën për politikën e saj ekonomike. Më parë këtë muaj, zëvendës-presidenti Mike Pence akuzoi Pekinin për përdorimin e praktikave tregtare "grabitqare" dhe agresion ushtarak.

Kina nuk ka komentuar për mediet amerikane pas takimit mes sekretarit Mattis dhe ministrit Wei gjatë konferencës së Shoqatës së Vendeve të Azisë Juglindore.

## ShBA-ja i kërkon Turqisë provat që dëshmojnë vrasjen e gazetarit saudit



WASHINGTON, 18 TETOR - Shtetet e Bashkuara i kërkuar Turqisë një audio-regjistrim për të cilin kjo e fundit tha se ofron dëshmi të fuqishme se gazetari saudit Jamal Khashoggi është vrarë në Konsullatën saudite në Stamboll. "E kemi kërkuar, nëse ekziston", tha presidenti amerikan Donald Trump për gazetarët në Shtëpinë e Bardhë. Gazeta "Washington Post" pub-

likoi artikullin e fundit që Khashoggi, kritik i udhëheqjes saudite, ka shkruar përpara se të zhdukej. Në këtë shkrim ai flet për rëndësinë e shtypit të lirë në Lindjen e Mesme.

Redaktorja e opinioneve globale në "Washington Post", Karen Attiah, tha se publikimi i shkrimit është shtyrë me shpresën se Khashoggi do të kthehet i gjallë. "Tani duhet ta

pranoj: kjo nuk do të ndodhë. Ky është artikulli i fundit i tij i shkruar për gazetën "The Post", tha ajo.

Arabia Saudite është një nga aleatët më të afërt të Uashingtonit dhe zhdukja e Khashoggit duket se e ka vënë administratën Trump në një pozitë të vështirë. Presidenti Trump tha se e vërteta për Khashoggin do të dalë deri në fund të javës.

## Sulmi në Krime, hetohet mundësia e bashkëpunësorëve

KERCH, 18 TETOR - Autoritetet ruse në Krime po hetojnë nëse nxënësi që qëllon për vdekje të paktën 20 veta dhe plagosi mbi 50 të tjerë në një shkollë profesionale në qytetin Kerch në Detin e Zi kishite bashkëpunësorë në këtë akt.

Sergei Aksionov, udhëheqës i emëruar nga Kremli për krimenë, tha të enjten në një konferencë me gazetarë në Moskë, se autori i masakrës Viacheslav Rosliakov, i cili më pas vrau veten, nuk mund ta ketë kryer aktin i vetëm. "Synimi është të zbulojmë kush e ka ndihmuar

në këtë akt", tha Aksionov. "E dimë që kur qëllon ishte i vetëm, por ky njeri mizor nuk ka si ta ketë organizuar vetë këtë sulm, mendoj unë dhe kolegët e mi", tha ai.

Me gjithë pohimet e zyrtarit, hetuesit rusë nuk po ndiqnin këtë pistë në hetimet e menjëhershme pas sulmit. Presidenti Vladimir Putin u shpreh se sulmi ishte "rezultat i globalizimit". "Në mediet sociale, në internet, shohim se është krijuar një komunitet i tërë. Çdo gjë e ka zanafillën tek aktet tragjike në shkollat amerikane", tha presi-

denti rus në një forum politik në Soçi. Sipas Putinit, është krijuar një gjeneratë të rinjsh të paqëndrueshëm, me "heronj të remë" dhe "që duan të kryejnë akte heroike" në mungesë të gjërave të vërteta.

Të mërkurën 18 vjeçi Vladislav Roslyakov vrau të paktën 20 studentë dhe plagosi më shumë se 40 të tjerë në një shkollë të mesme profesionale në gadishullin e aneksuar nga Moska, përpara se të vriste veten. Rusia e aneksoi me forcë krimenë nga Ukraina katër vjet më parë, që u pasua nga sanksione ekonomike të Perëndimit.





# Studimi i ri, kanabisi ngadalëson plakjen e trurit

Kanabisi, deri më tani një drogë me nam të keq, mund të kthehet në një bimë mjekësore të shumëanshme. Si mjet kundër dhimbjeve kanabisi ndërkohë është pranuar. Me gjasë kjo bimë ka efekt edhe tek disa sëmundje psikike dhe mund të ketë madje edhe efektin e rinimit të trurit.

Këtë e thonë studiuesit e Institutit për Psikiatrinë Molekulare në Universitetin e Bonnit pas eksperimenteve me minj. Tek minjtë më të vjetër duken shenja të qarta ndryshimi pas dhënies së një doze të vogël të lëndës përbërëse të kanabisit Tetrahydrocannabinol (THC). Tek ata përmirësohen funksionet e trurit, raportojnë studiuesit në revistën "Nature Medicine".

Drejtori i Institutit, Andreas Zimmer është optimist, që ky rezultat mund të transferohet edhe tek njerëzit. Për këtë do të fillojë së shpejti një studim klinik me të moshuar në Bonn. Studiuesit duan të dinë, nëse THC ka ndikim në funksionet e trurit të njerëzve me demencë në stadin e parë apo në fillimet e

Alzheimer.

**Kura e rinimit me kanabis** – Receptorët që kanë qenë objekt studimi, i ashtuquajturit sistemi "Endocannabinoid" si pjesë e sistemit nervor ka efekt ndikues në të gjitha proceset e plakjes. „Aktiviteti i këtij sistemi tek kafshët në moshë zbret, dhe tregohen kështu shenjat tipike të plakjes”, thotë Zimmer. Pasoja janë osteoporozja, lëkura me rrudha, por edhe aftësia e dobësuar e trurit për të mësuar dhe kujtesa. Studiuesit shpresojnë t'i japin kështu „höv” sistemit Endocannabinoid.

**Eksperimenti** – Studiuesit iu dhanë minjve të plakur THC. Dhe efekti ishte i dukshëm – minjtë e vjetër nuk dalloheshin më nga të rinjtë. Para dhënies së kanabisit, ata kishin vështirësi të dallonin një mi, me të cilin kishin qenë në kontakt. Në vend të kësaj, ata reagonin me frikë dhe agresivitet. Pas dhënies së THC-së, minjtë e vjetër i dallonin shumë mirë minjtë me të cilët kishin pasur një lloj marrëdhënie, thotë, Andras Bilkei-Gorzo, koleg i Andreas Zimmer.

**Efekt** – Studiesit janë marrë 15



vjet rresht me studimin e receptorëve, ku kanabisi ka pasur ndikimin e tij, në radhë të parë tek minjtë. "Ne njerëzit kemi një sistem 'Endocannabinoid' shumë të njëjtë me minjtë.", thotë Bilkei-Gorzo në bisedë me

Deutsche Wellen. Receptorët janë në sfera të përafërta në tru. Prandaj kanabisi ka gati po të njëjtin efekt tek njerëzit si tek minjtë." Edhe në Izrael studiuesit janë marrë me hulumtime mbi efektin e kanabisit dhe kanë

arritur në përfundime pozitive. Në një azil pleqsh, banorët që kishin probleme me pagjumësinë dhe oreksin morën kanabis. Shumë prej tyre ishin pastaj shumë më aktivë. (gazeta-Shqip.com)

## Ndryshimi i klimës rrezikon prodhimin e birrës

Ndryshimet klimatike do të krijojnë probleme për ata që pinë birrë, pija alkoolike më popullore e botës. Arsyja është se ndryshime të tilla pritet të sjellin rënien e prodhimit të elbit, elementi kryesor i birrës, sipas një studimi të publikuar të hënën. Nëse temperaturat rriten me ritmet e tanishme, thuhet në studim, moti ekstrem me valë të nxehti dhe me thatësi do të jetë mjaft i shpeshtë, çdo dy ose tre vjet në gjysmën e dytë të shekullit.

Prodhimi mesatar i elbit në botë gjatë periudhave me mot ekstrem pritet të bjerë mes 3 dhe 17 për qind, në varësi të kushteve, thuhet në studimin e botuar në revistën Nature Plants.

Më pak elb do të thotë mungesë birre dhe rritje e çmimeve. Në një skenar klime të nxehtë, Kina do të ketë rëniet më të mëdha të prodhimit këtë shekull, pasuar nga Shtetet e Bashkuara, Gjermania dhe Rusia, sipas studimit.

Çmimet do të rriten më shumë në Irlandë, Itali, Kanada, Francë dhe Poloni. Gjatë periudhave të tilla, çmimet për një shishe birre 500 mililitëshe në Irlandë do të

rriten nga rreth 2.5 në 5 dollarë. Birra është pija alkoolike më e vjetër dhe më e njohur në botë. Shiten më shumë se 133 miliardë litra birrë në vit. Prodhohet nga tharmëtimi i lëndëve me bazë niseshtenë, zakonisht përdoret elbi, megjithëse përdoren edhe rrënjët e kasavës (Manihot esculenta) në Afrikë, patatja në Brazil dhe Agava (lloj kaktusi) në Meksikë.

Vetëm pijet e prodhuara në këtë mënyrë konsiderohen birra të mirëfillta. Për shkak të përbërësve dhe ecurive të përdorura nga prodhuesit e birrës, birra mund të ndryshojë vetitë e saj në shije dhe ngjyrë.

Nuk dihet me saktësi se kur u zbulua birra. Në vitin 1926, në një muze të Londrës ruheshin dy pllaka të lashta, që fillimisht konsideroheshin se ishin shkruar 9 000 vjet më parë. Arkeologu Huber mbështeste teorinë se në këto pllaka përshkruhej mënyra e bluarjes së drithit emmer (Triticum dicoccon), dhe se ishte prova më e lashtë e prodhimit të birrës. Por më vonë, hetimet e kryera nga shkencëtarë të tjerë provuan se këto pllaka nuk ishin aq të vjetra sa i



mbështeste Huberi.

Sot, provat më të lashta për ekzistencën e birrës mendohet të jenë rreth më se 6 000 vjet dhe përshkruhen nga sumerët, të cilët kishin një qytetërim mjaft të lashtë Sumerët.

Sumerët e zbuluan rastësisht procesin e fermentimit, ndoshta nga një copë bukë që u lag dhe u harrua. Pas pak kohe ajo fillojë të fermentohet me ndihmën e disa baktereve të ajrit, duke u kthyer në një masë alkoolike.


Sumerët ishin mjaft të zgjuar. Ata e kuptuan këtë proces dhe e kopjuan, duke u bërë kështu populli i parë në botë që prodhoi birrën, si ofertë për perënditë e tyre. (gazeta-Shqip.com)



## Georgina publikon një imazh me Ronaldon, në gisht mban një unazë fejese



**G**eorgina Rodriguez ka shkaktuar thashetheme të mëdha në mesin e mediave botërore. E dashura e Cristiano Ronaldos, Rodriguez, ka publikuar një fotografi në rrjetet sociale që ka bërë të hamendësohet shumëkush. Ajo publikoi imazhin e përbashkët me portugezin teksa në "gishtin e fejesës" mbante një unazë, e cila bëri që të raportohet se çifti janë fejuar.



## Femrat turke 'çmenden' pas aktorit shqiptar



**A**ktori shqiptar që zhvillon karrierën në telenovelat turke është shpallur mashkulli më i preferuar i femrave në Turqi. Në një sondazh nga faqja "Gecce", ndjekësit duhet të zgjidhnin mes katër aktorëve. Can Yaman ishte ai

që triumfoi me 50,1 për qind pëlqime. Më pas, në renditje u radhitën Burak Özçivit me 24.4 për qind vota dhe Enis Arikan me 12 për qind. Can është me origjinë shqiptare, ndonëse ka lindur dhe është rritur në Turqi.



## Valeria Marini, e çmendur nga "demi" i Seviljas

**V**aleria Marini hyri në serialin televiziv "Temptation Island" me të dashurin e saj Patrick për ta provuar dashurinë e tyre. Por brenda reality shout ajo gjeti Ivan Gonzales, një simpatik

26-vjeçar nga Spanja, pas të cilit thotë se ka humbur mendjen. "Unë e quaj atë demi i Seviljes, edhe pse ai është nga Madridi", thotë ajo për të përjavshmen "Chi".

## Modeluesja e famshme pranon se ka hapur llogari false për t'i kontrolluar ish të dashurit



**S**upermodelueset më të paguara në botë, Kendall Jenner dhe Hailey Baldwin, janë bërë pjesë e lojës së 'makines së të vërtetës'. Në intervistën e tij moderatori James Corden vendosi t'i përballë mikeshat për ta pyetur njëra-tjetrën rreth jetës

personale. Kështu Hailey pyeti Kendall nëse ajo ka hapur ndonjë llogari false për t'i kontrolluar ish të dashurit. "Ti e di përgjigjen e kësaj. Po!", ka deklaruar modeluesja më e paguar në botë pasi e dinte se e vërteta do të zbulohet.



E rrallë

## 25-vjeçares i vënë Iphone për gur varri

Vizitorët e varrezave në Ufa të Rusisë u habitën kur panë se një gur varri ishte në formë Iphone. Telefoni prej guri bazalti është i realizuar me detaje, ka edhe logon e Apple në pjesën e pasme, madje edhe një QR-Code. Guri i varrit u ndërtua nga babai, i cili e vuajti shumë humbjen e vajzës 25-vjeçare. Ajo vdiq në vitin 2016 nga shkaqe ende të paqarta.



FOTO E DITES



Dielli depërton midis ndërtesave në Manhattanit. /Nacional Geographic/

E jashtëzakonshme

## Barcelona eksporton "verën blu"

Pesë vjet më parë një grup studentësh të Universitetit të Barcelonës vendosën të bënin diçka për të shkundur një sektor, çdo sektor, por me preferenca për ushqimin apo pijet. Sidoqoftë, ata zgjodhën më tradicionalen e të gjithave dhe krijuan "verën blu", duke sjellë një risi në një industri shumë konservatore. Ata shitën 30 mijë shishe vitin e parë dhe iu afruan numrit 500 mijë në vitin 2017. Tani ata eksportojnë në 21 shtete, me Shtetet e Bashkuara që



mbajnë vendin e parë, dhe me Francën dashamirëse të verës në të dytin.

## BARSOLETA E DITËS



Nataliteti

- A po sheh se çdo vit e më pak foshnja po lindin, - thotë njëra.

- Po, po, prandaj na ka ra mentaliteti!, ia kthen tjetra.




### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### “ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

#### “JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.

Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

#### “NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.

Regjia: Malcolm D. Lee




Në ora 20:00

#### “SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.

Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

#### “VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.

Regjia: Ruben Fleischer  
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.

<p><b>DASHI</b> Sot jeni shumë të përkushtuar për miqësitë e reja. Keni në fokus vetëm mirëqenien tuaj mendore dhe po neglizhoni çdo gjë tjetër.</p>	<p><b>DEMI</b> Dëshira për hapësirë dhe autonomi mund të keqkuptohet nga partneri sot. Do të mendoje se po kërkonte ta shmangni në disa gjëra.</p>	<p><b>BINJAKËT</b> Edhe pse do të keni të papritura në fushën e karrierës nuk duhet të impresionoheni. Shpirti juaj praktik do të arrijë të zgjidhë çdo gjë.</p>	<p><b>GAFORRJA</b> Keni kuptuar që po ndryshojnë ndjenjat në lidhje me një mikun tuaj dhe kjo gjë ju ka vënë në panik. Nuk doni të humbni atë që keni me të.</p>	<p><b>LUANI</b> Ditë mjaft e komplikuar kjo e sotmja dhe ju nuk dini si të veproni. Keni parë edhe ditë të tjera të ngjashme, por që keni arritur t'i menaxhoni.</p>	<p><b>VIRGJËRËSHA</b> Ngjarjet rreth jush po jua bëjnë gjithnjë e më të qartë që jeni gati për t'i bërë valixhet për një vend të huaj. Gjithmonë ndryshimet janë të mira.</p>
<p><b>PESHORJA</b> Mendoni se është zvenitur pasioni me partnerin, por një surprizë nga ana e tij sot do të tregojë që çdo gjë është si në ditët e para.</p>	<p><b>AKREPI</b> Jeni mbytës në disa momente me ndjenjat tuaja. Kjo përkthehet në panik tek partneri, i cili përpiqet t'ju shmangë duke ju lënduar.</p>	<p><b>SHIGJETARI</b> Ambienti i punës po ju thith gjithë energjitë sot dhe në fund të një ditë të lodhshme pune, ju do të ndiheni të këputur.</p>	<p><b>BRICJAPI</b> Jeni mjaft i ndjeshëm këto ditë. Për shkak të një kujtimi të këndshëm ose të një personi që është bërë i gjallë përsëri në jetën tuaj.</p>	<p><b>UJORI</b> Sot do të keni debate në familje që do të iniciohen nga ju si pasojë e një gjendjeje emocionale të ngarkuar për shkak të punës.</p>	<p><b>PESHQIT</b> Ndryshoni mendim çdo pesë minuta për gjërat dhe hapat që do të ndërmerreni në të ardhmen. Ky konfuzion i juaji do të reflektohet edhe te të tjerët.</p>



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BARRY TOWN - LLANELLI

1

FRANKFURT - DUSSELDORF

1

DRESDEN - AUE

1

## FIFA: Kosovën e pret një e ardhme e ndritur

"Duhet ta mbani mend se ne filluam me asgjë. Federata jonë ka bërë një punë të mrekullueshme në vitet e fundit. Stadiumi tani është licencuar dhe ne e kemi ligën tonë. Ne mund ta zhvillojmë stilin tonë të lojës dhe lojtarët kanë filluar të kenë më shumë përvojë", ka thënë Samir Ujkani, kapiten i Përfaqësues së Kosovës

PRISHTINË, 18 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll këtë muaj zhvilloi dy ndeshje në Ligën e Kombeve ndaj Maltës dhe Ishujve Faroe, kurse faqja zyrtare e FIFA-s e ka publikuar një artikull, ku flitet për ngritjen e madhe të "Dardanëve". Në këtë artikull protagonist është kapiteni i Kosovës, Samir Ujkani. Kosova e kishte shpallur pavarësinë para më shumë se dhjetë vjetëve, megjithatë iu nevojitën edhe tetë vjet të tjera para se Kongresi i FIFA-s ta pranonte në familjen e futbollit ndërkombëtar. Tani Kosova i ka vënë vetes disa synime mjaft ambicioze dhe duket se është në rrugë të drejtë për sukses. Dardanët kishin kaluar në një periudhë të vështirë gjatë fazës kualifikuese për Kupën e Botës, duke e marrë vetëm një pikë nga 10 ndeshje. Megjithatë, kjo gjë pritej për shkak se rivalët në grup kishin skuadra mjaft të mira: Kroacia, Turqia, Islanda, Ukraina dhe

Finlanda. "Duhet ta mbani mend se ne filluam me asgjë. Federata jonë ka bërë një punë të mrekullueshme në vitet e fundit. Stadiumi tani është licencuar dhe ne e kemi ligën tonë. Ne mund ta zhvillojmë stilin tonë të lojës dhe lojtarët kanë filluar të kenë më shumë përvojë", ka thënë Samir Ujkani, kapiten i Përfaqësueses së Kosovës. "Dardanët" vazhdojnë të ngjiten më lart në radhitjen e FIFA-s dhe tanimë kanë arritur në pozitën e 138. Së fundi, Kosova e fitoi ndeshjen e parë me karakter garues, kur i mposhti Ishujt Faroe me rezultat 2-0. Në ndeshjet e fundit arriti ta mposhtë edhe Maltën me rezultat 3-1, ndërsa mbeti baras me rezultat 1-1 kundër Ishujve Faroe si mysafirë.

Nën menaxhimin e trajnerit Bernard Challandes, i cili u emërua pasues i Albert Bunjakit rreth një vit më parë, Kosova ka arritur ta zë pozitën e parë në grupin e tretë të Ligës D të Ligës së



Kombeve dhe shpreson se do të mund të promovohet në Ligën C. "Jemi shumë të lumtur me këtë. Mendoj se mund të arrijmë edhe në top 100-en e rangimit të FIFA-s pas disa muajve. Ky është qëllimi ynë. Pasi ta arrijmë këtë, do të vendosim synime të tjera", është shprehur Ujkani. "Puna ime është t'i mbajë të tjerët të lumtur, pasi ne jemi të suksesshëm kur jemi në humor të mirë. Ne duhet të punojmë si ekip dhe të kalojmë mirë së bashku. Edhe kur lojtarët e rinj janë në bankën rezervë, unë tentoj

të flas me ta dhe të krijoj një atmosferë pozitive. Ne jemi si familje. Pas dy apo tre vjetëve Kosova do të jetë përmirësuar mjaftueshëm sa edhe ta fitojë një grup në ndonjë garë", ka deklaruar Ujkani.

Kampionati Evropian i vitit 2020, i organizuar nga UEFA, është një ëndërr të cilën Kosova po tenton ta bëjë realitet. "Në fillim tifozët tanë nuk kishin durim dhe menduan se ne do të arrinin ta fitonim grupin për t'u kualifikuar në Kupën e Botës menjëherë, por askush nuk

mund ta priste një gjë të tillë. Kemi mësuar shumë nga kjo, kur duhet ta sulmojmë kundërshtarin dhe kur të mbrohemi", ka thënë Ujkani, duke shtuar: "Ndaj Azerbajxhanit, para disa javëve, vetëm e largonim topin nga zona për ta larguar presionin nga kundërshtari. Ky ishte një mësim i vlefshëm për mua dhe bashkëlojtarët e mi. Ne nuk rrezikojmë aq shumë tani dhe vazhdimisht po tentojmë ta gjejmë baraspeshën në mes të sulmit dhe mbrojtjes". Liga vendore na ndihmon shumë me këtë gjë. Lojtarët janë duke u rritur me rolet e tyre dhe janë duke u sfiduar te klubet e tyre. Kjo, natyrisht, i ndihmon edhe Kombëtares".

Me top 100-en para syve, Kampionatin Evropian në mendje, synimet ambicioze dhe pritshmëritë e larta, nuk ka asnjë dyshim se Kosova është duke u përmirësuar. Kur u pyet se me cilat kombëtare do të dëshiron të ndeshet ndonjë ditë, kapiteni 30-vjeçar u përgjigj: "Brazilin ose Argjentinën! Ne do të ndeshemi me kombëtares evropiane gjatë ndeshjeve kualifikuese për Kampionatin Evropian, por një duel me Lionel Messin, Neymarin dhe lojtarë të tjerë të klasës botërore do të ishte e mrekullueshme për vendin".

## Gjinnastet kërkojnë suksese në Slloveni

Gjinnastet Vilëza Zeqiri, Valëza Rama, Amela Gërbeshi dhe Bora Hoti, të prira nga trajnerët Shkumbin Maqestena dhe Abeliana Bregu, pritet ta përfaqësojnë Kosovën në Slloveni në garën e "Salamunov Memorial 2018", e cila mbahet nga 19 deri më 21 tetor. Klubi i "Elitës" është përkrahur nga prindërit e gjinnasteve dhe disa kompani biznesore, por jo edhe nga Federata e Gjinnastikës

### "Epoka e re"

PRISHTINË, 18 TETOR - Klubi i Gjinnastikës "Elita" kërkon suksesin e radhës në garën "Salamunov Memorial 2018", i cili organizohet në Maribor nga Federata e Gjinnastikës së Sllovenisë dhe nën patronazhin e FIG (Federata Internacionale e Gjinnastikës). Klubi i Gjinnastikës nga Prishtina ka mbërritur në Slloveni, kurse do të përfaqësohet në dy kategori. Në kategorinë Children do të përfaqësohet nga Amela Gërbeshi dhe Bora Hoti, kurse në kategorinë Youth do të përfaqësohet nga

Vilëza Zeqiri dhe Valëza Rama. Pjesëmarrja e gjinnasteve në këtë garë është bërë me iniciativën e Klubit të Gjinnastikës "Elita", në mbështetje shumë të madhe edhe të prindërve të fëmijëve garues, si dhe disa kompanive private: "Armakos Sh.PK", "Evko Sh.PK", "Redoni Sh.PK" dhe "Melodia PX". Klubi i "Elitës" ka falënderuar këto kompani biznesore për përkrahjen, derisa ka vlerësuar se kjo garë është e rëndësishme për gjinnastikën dhe shtetin e Kosovës në përgjithësi. "Ky aktivitet është shumë i rëndësishëm për klubin 'Elita', por edhe për shtetin e Kosovës, pasi në këtë garë do të



marrin pjesë shtete të ndryshme të botës si Kroacia, Sllovakia, Hong Kongu, Izrael, Egjipti, Austria, Gjermania dhe Anglia. Një aktivitet me rëndësi dhe konkurrencë të madhe për ne, por që shpresojmë që vajzat tona të na nderojnë me një përfaqësim sa më të mirë, duke

ngritur sa më lart emrin e gjinnastikës së Kosovës dhe sigurisht flamurin e Kosovës", thuhet në njoftimin e klubit "Elita". Në njoftimin e klubit prishtinas të gjinnastikës është bërë me dije se ka munguar përkrahja nga Federata e Gjinnastikës. "Vlen të theksohet se nga

Federata e Gjinnastikës e Kosovës nuk kemi pasur asnjë mbështetje për shkak të vonesës që ata kanë për marrjen e fondit, gjë e cila është bërë pengesë e madhe qoftë për aktivitetin që ne po marrim pjesë, po ashtu edhe për mungesën e organizimit të garave në rang kombëtar", thuhet në njoftim. Ndërsa Federata e Gjinnastikës e Kosovës i ka uruar suksese KGJ "Elita", kurse ka bërë me dije se përkrahja financiare është bërë për shkak të vonesave nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. "Federata e Gjinnastikës e Kosovës mbetet e brengosur, përveç përkrahjes procedurale të aplikimit në këtë garë, për shkak të vonesave financiare nga MKRS-ja. Klubi është dashur të përkujdeset vetë për sigurimin e fondeve, megjithatë FGJK-ja e përkrah dhe do t'i përkrahë në vazhdimësi. Gjinnasteve dhe trajnerëve tanë Abeliana Bregut dhe Shkumbin Maqestenas, FGJK-ja u dëshiron suksese", thuhet në njoftimin e Federatës së Gjinnastikës.



## Shefi i ekipit olimpik: Gjithçka shkoi mirë për Kosovën

PRISHTINË, 18 TETOR - Jeton Rudari ishte shef i misionit të Ekipit Olimpik të Kosovës për Lojërat Olimpikë për të rinj, Buenos Aires 2018. Që prej 1 tetorit, kur është nisur ekipi olimpik për në kryeqytetin e Argjentinës, ai është duke u

përkujdesur për sportistët, trajnerët, për mbarëvajtjen e garave, disiplinën etj. "Përvoja e marrë nga lojërat e kaluara ndërkombëtare më ka ndihmuar që edhe këtë herë të mos kemi ndonjë problem dhe të përkujdesem për gjithçka që

ishte e nevojshme si për sportistët, trajnerët, po ashtu edhe për tërë delegacionin që mori pjesë në Buenos Aires 2018", ka thënë Rudari për "noc-kosovo.org". Ai falënderoi gjithë Ekipin Olimpik të Kosovës për disiplinën e reguar si në

Fshatin Olimpik, po ashtu edhe gjatë garave. Në Buenos Aires 2018 morën pjesë edhe drejtuesit e lartë të Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në krye me ministrin Kujtim Gashi. Ekipi Olimpik i Kosovës kthehet të dielën në Prishtinë.



## Zëvendësministri Mazreku: Do të ndihmohen federatat sportive

PRISHTINË, 18 TETOR - Zëvendësministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Rexhep Mazreku, ka vizituar Federatën e Gjymnastikës së Kosovës, ku është pritur nga kryetari i kësaj federate, Besim Halilaj. Zëvendësministri Rexhep Mazreku falënderoi kryetarin Halilaj për pritjen e tij. Ai ka thënë se qëllimi i kësaj vizite është për t'u njohur më afër me aktivitetet e kësaj Federate dhe me kushtet në të cilat punon Federata. Ai u premtoi mbështetje dhe u zotua se do të jetë çdoherë afër sportistëve. "Kjo vizitë është në vazhdim e vizitave dhe aktivitetet të mia nëpër komunitet e Kosovës dhe Federatat e Sportit të Kosovës. Qëllimi ynë është që bashkëpunimin me



FGJK-në dhe me federatat në përgjithësi mos ta ndalim asnjëherë në mënyrë që përmes këtij bashkëpunimi t'i ndihmojmë sportistët dhe federatat e sportit për realizimin e aktivitetet të tyre dhe sukseseve

në garat ndërkombëtare të sportit", ka thënë Mazreku. Ndërkaq kryetari i FGJK-së, Besim Halilaj, fillimisht i uroi mirëseardhje zëvendësministrit Mazreku. Ai e informoi zëvendësministrin në lidhje me përbërjen e Federatës duke thënë se përbëhet nga 14 klube aktive. Ai foli edhe rreth aktiviteteve dhe pjesëmarrjes në gara të ndryshme ndërkombëtare dhe për rezultatet e sportistëve gjymnastë. Kryetari Halilaj falënderoi zëvendësministrin për vizitën e tij dhe për gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar dhe për t'i përkrahur sportistët gjymnastë, duke e vlerësuar vizitën e tij shumë të rëndësishme dhe motivuese për federatën dhe sportistët.

## 'Epoka' kërkon fitoren e radhës në Media Ligë

PRISHTINË, 18 TETOR - Ekipi lider i Media Ligës, "Epoka e re", kërkon fitoren e radhës në kuadër të xhiros së gjashtë ndaj "Gazeta Blic". Duke parë rezultatet e deritani, ekipi i "Epokës" llogaritet favorit absolut për të fituar edhe këtë përballje, kurse punë të lehtë e pret edhe ekipin e dytë në tabelë, "Lajmi.net", pasi përballje të tyre do të jetë ekipi i "D+".

### JAVA E GJASHTË:

'D+' - 'Lajmi.net'  
'Gazeta Zëri' - 'Infokusi'  
'Epoka e re' - 'Gazeta Blic'  
'Klan Kosova' - 'InfoKosova & PrishtinaPost'  
'KosovaPress' - 'Kallxo.com'  
'Telegrafi' - 'RTV Dukagjini'  
'Gazeta Metro' - 'RTK'  
'Media Works' - 'Ora Info'



